

VENDIM
Nr. 728, datë 20.10.2016

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s “AEGEAN SEA”¹

(Ndryshuar me VKM nr. 339, datë 19.4.2017; nr. 725, datë 8.12.2017; nr. 681, datë 14.11.2018)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes e të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s “Aegean Sea”, të përbërë nga 21 (njëzet e një) ushtarakë dhe 1 (një) anije e klasit “Iliria” si dhe 1 (një) ushtarak oficer shtabi, në Grupin Detar të Përbershëm të NATO-s, në anijen flamurtare.

2. Misioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë operacion është kryerja e patrullimit detar në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2, në detin Egje dhe për personelin në anijen flamurtare, në bazë të kërkesave operacionale të saj, edhe në detin Mesdhe dhe Detin e Zi, në kuadër të operacionit të NATO-s “Aegean Sea”.

3. Kohëzgjatja e pjesëmarrjes në këtë operacion e anijes së klasit “Iliria” dhe personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është, si më poshtë vijon:

a) Për anijen e klasit “Iliria”, deri më 30 nëntor 2019, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit të anijes është çdo 6 (gjashtë) muaj;

b) Për 21 (njëzet e një) ushtarakë, deri më 30 nëntor 2019, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit është çdo 3 (tre) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës;

c) Për ushtarakun, oficer shtabi, në Grupin Detar të Përbershëm të NATO-s, në anijen flamurtare, deri më 31 dhjetor 2019, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit është çdo 3 (tre) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.

4. Rajoni i vendndërkimit të anijes së klasit “Iliria” dhe i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë, si më poshtë vijon:

a) Për anijen e klasit “Iliria” dhe 21 (njëzet e një) ushtarakë, në detin Egje;

b) Për ushtarakun, oficer shtabi, në Grupin Detar të Përbershëm të NATO-s, në anijen flamurtare, në detin Egje dhe në bazë të kërkesave operacionale të anijes flamurtare, në detin Mesdhe dhe Detin e Zi.

5. Ministria e Mbrojtjes, për personelin pjesëmarrës në këtë operacion dhe për anijen, të përballojë shpenzimet, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqim;

ç) akomodim;

d) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

¹ VKM nr.728, datë 20.10.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 199, datë 28 tetor 2016.
VKM nr.339, datë 19.4.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 88, datë 25 prill 2017.
VKM nr.725, datë 8.12.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 223, datë 20 dhjetor 2017.
VKM nr. 681, datë 14.11.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 166, datë 21 nëntor 2018.

- dh) mbështetje shëndetësore;
 - e) telefon, *instalim të radiave të komunikimit*, komunikim SATCOM, internet, shërbim postar;
 - ë) sigurimin e anijes;
 - f) karburant, lubrifikantë;
 - g) shërbime lundrimi (taksa portuale, pilot, ujë, derdhje të ujërave të zeza, akostim qëndrimi, lavanteri etj.);
 - gj) mirëmbajtjen teknike dhe riparime të anijes, të paparashikuara;
 - h) transportimin e individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
 - i) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare gjatë kohës së kryerjes së misionit;
 - j) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.
6. Transporti i personelit të anijes që do të marrë pjesë në operacion, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe ku pala/ët tjetër/e tjera merr/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.
7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë operacion.
8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.
9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama